

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E
AKTIVITETIT:
"UZINA E PERPUNIMIT TE NAFTES"


Vendodhja : Ne Kompleksin Industrial te
qytetit Fier.

Kërkues: Subjekti: "AL.GLOBAL OIL" Sh.p.k

Hartoi:

"ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS" Sh.p.k

Administrator
Elidiana Shehu



Altin Ahmeti
(Çert. 261, Nr. 11657 Prot, dt. 10.12.2014)

Ing. Elidiana Shehu
(Lic.146, Nr. 5113 Prot, date 28.07.2013)

Mars, 2018

TABELA PERMBLEDHESE

1	HYRJE	3
1.1	TE PERGJITHSHME	3
1.2	VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS	3
2	PERSHKRIM I KUADRIT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL	3
2.1.	KUADRI LIGJOR KOMBETAR	3
3	PERSHKRIM I MJEDISIT TE RAJONIT	4
3.1	TE PERGJITHSHME	4
3.1.1	GJELOGJIA.....	4
3.1.1	TEKTONIKA DHE SIZMICITETI NE RAJON	5
3.1.2	GJEOMORFOLOGJIA	6
3.1.3	KUSHTET KLIMATIKE	7
3.1.4	MJEDISI TOKËSOR	11
3.1.5	RRJETI HIDROGRAFIK NATYROR I ZONËS	11
3.1.6	KUSHTET ATMOSFERIKE	12
3.1.7	ZHURMAT.....	14
3.1.7	ZONAT E MBROJTURA	15
3.1.8	MJEDISI BIOLOGJIK I RAJONIT.....	16
4	PERSHKRIMI I AKTIVITETIT	17
4.1	QELLIMI I AKTIVITETIT	17
4.2	VENDODHJA E AKTIVITETIT.....	17
4.3	TE DHENA TEKNIKE TE AKTIVITETIT.....	19
4.3.1	PROCESI TEKNOLOGJIK I PRODHIMIT TE RAFINERISE FIER	19
4.3.2	TEKNOLOGJIA	19
4.3.3	PERSHKRIMI I SKEMES TEKNOLOGJIKE TE UZINES SE PERPUNIMIT TE NAFTAES FIER.....	20

1 HYRJE

1.1 Te pergjithshme

Uzina egzistuese e Perpunimit te Naftes Fier ndertuar ne vitet '60 ka filluar aktivitetin e saj perpunues ne vitin 1968. Kjo uzine ndodhet ne Jug-Perendim te Ish Azotikut, ne kompleksin Industrial te qytetit te Fierit. Ky aktivitet ka qene i pajisur me leje mjedisi referuar ligjit per Lejet e Mjedisit me nr 775 Prot, date 11.11.2008 dhe referuar ndyshimeve te fundit te legjislacionit mjedisor duke qene se kjo uzine do te riaktivizohet do te pajiset me leje te re mjedisore .

Subjekti “AL.GLOBAL OIL” Sh.p.k me NIPT: L62214509P dhe me administrator Z. Shaban Guni kompani e cila ushtron te drejten e pronesise se kesaj Uzine , eshte nje subjekt tregtar NIPT L62214509P me seli ne Tirane, Njesia Administrative Nr.5,Rruga "Sulejman Delvina", Ndertesa.11, Hyrja 10, Ap.7,1019 , objekt veprimtarie ne fushen e Importit dhe eksportit te hidrokarbureve te gjitha llojeve, te karburanteve, naftes, gaz dhe nenprodukteve te tyre me shumice si dhe perpunimi i naftes bruto dhe nenprodukteve te saj.

Raport I meposhtem eshte informues per pale interesi ne nje proces informimi me publikun.

1.2 Vlerësimi I Ndikimit në Mjedis

Raporti i thelluar i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) do te perpilohet me qellim vleresimin e ndikimeve ne fazen e riaktivizimit, duke siguruar një përmbledhje të të dhënave ekzistuese dhe informacion mbi kushtet e zhvillimit te aktivitetit.

Vleresimi i ndikimit ne mjedis hartohet dhe do te bashkelidhet ne Shtojcen per Leje mjedisi te ketij aktiviteti.

2 PERSHKRIM I KUADRIT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

2.1. Kuadri ligjor kombetar

Bazuar ne Ligjin Nr. 10448, date 14.07.2011 Per lejet e mjedisit, ne Aneksin Nr.1 ,ky projekt eshte i perfshire ne listen e aktiviteve qe duhet te pajisen me leje mjedisore, sipas percaktimeve te ketij ligji, per te gjitha instalimet klasifikohet si aktivitet per tu pajisur me leje tipi A.

Sipas Ligjit Nr.10 440, date 07.07.2011 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” dhe VKM Nr. 686, datë 29.07.2015 “Për proceduren e VNM-se”, ky projekt perfshihet ne shtojcen 1 te ketij ligji. Aktiviteti ne fjale

eshte i pajisur me leje mjedisore ne vitin 2008 ne emer te subjektit “ARMO”sh.a dhe per tu ripajisur subjekti me Leje te Re Mjedisore do behet njehsimi i Lejes se vjeter, me Deklarate Mjedisore.

Me tej per te aplikuar per pajisje me leje mjedisore tipi A, kerkohet konsultimi me publikun, per te cilin lind nevoja e hartimit te Permbledhjes Jo-Teknike te raportit te VNM-je, per tu publikuar ne faqen zyrtare te AKM-se, DRM-se perkatese dhe Njesise se Qeverisjes Vendore, ne perputhje kjo me kerkesat e VKM Nr. 419, date 25.06.2014.

Ligji mbi Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis (VNM) percakton tipin dhe shkallen e projekteve apo veprimtarive qe kerkojne VNM para implementimit. Kategorite e VNM-ve jane:

VNM e permbledhur. Ky vlen per projekte qe mund te kene impakte potenciale me te vegjel ne permasa qe serish kerkojne nje vleresim profesional te impakteve te tyre. Keto perfshijne projekte qe jane listuar ne Shojcen 2 te Ligjit per VNM dhe ndryshime apo rehabilitime te projekteve te listuar ne Shtojcen 1 dhe qe nuk klasifikohen ndryshe nga AKM.

VNM i Thelluar. Ky vlen per projekte me impakte potencialisht te konsiderueshme, siç figurojne ne listen e Shojces 1 te Ligjit, ato projekte te listuara ne Shtojcen 2 per te cilet Agjencia Kombetare e Mjedisit mendon se do te kene nje impakt te konsiderueshem mbi mjedisin (bazuar ne informacionin e siguruar nga propozuesi ne kohen e aplikimit) dhe veprimtarite qe jane per tu implementuar ne zonat e mbrojtura apo zona bregdetare te Republikes se Shqiperise.

Aktiviteti ne vleresim, ne baze te klasifikimit te tij si leje e tipit A, mund ti nenshtrohet edhe perditesimit te VNM se thelluar (ANEKS) dhe plotesimit te formularit te shtojces nr.1 te VKM Nr. 419, date 25.06.2014 Per lejet e mjedisit.

3 PERSHKRIM I MJEDISIT TE RAJONIT

3.1 Te pergjithshme

3.1.1 Gjeologjia

Zona në studim shtrihet në pjesën më perendimore të Ultësirës Pranadriatike. Ultësira Pran-adriatike përfshin terrenet kodrinore dhe fushore të basenit molasik Pranadriatik, i cili u themelua në Miocen të mesëm (Serravalian), fill pas rrudhosjes kryesore e mbihijes së zonës Jonike të jashtme, dhe mandej u mbush me molasen Miocenike dhe Pliocenike (Aliaj, 2000).

Ultësira Pranadriatike ndërtohet nga disa linja antiklinale relativisht të ngushta dhe sinklinale të gjera, lineare, me shtrirje veri-perendimore deri afër veriore.

Zona e projektit gjendet në antiklinalin Frakull-Ardenicë-Divjakë-Kryevidh-Durrës, mbarimi verior i të cilit ndiqet nën ujrat detare. Struktura e Ardenicës, e cila lokalizohet në veri të qytetit të Fierit, ndërtohet në sipërfaqe nga depozitime Pliocenike të formacionit “Rrogozhina”. Në zonën e projektit, mbi to vendosen depozitimet Kuaternare aluviale përfaqësuar nga zhavorre me ndërthurje argjilash suargjilash, me shtresa

dhe linza ranore e zhavorrite të çimentuara dobët, me trashësi deri disa dhjetra metra (150) në terrenet me tendencë në zhytje gjatë Kuarternarit1.

Figure 1 Harta gjeologjike e rajonit ku gjendet zona e projektit



Depozitimet që ndërtojnë zonën nga lart poshtë janë:

- Depozitimet e Kuarternarit (Holocen IaQh1+2) – depozitime kënetore të lagunës së Mbrostarit të cilat ndërthuren me depozitimet aluviale, të përbëra nga suargjila, argjila, argjila torfike, surëra, rëradhe rrallë zhavorre. Kanë trashësi 100-150 m.
- Depozitimet e Pliocenit të sipërm (N22rr) njohur si suita “Rrogozhina” të përbëra nga ranorë, ranorë gravelitikë, dhe konglomeratë me ndërthurje argjilash.
- Në dyshtemenë e tyre vendosen formacionet e suitës “Helmasi” (N21h) përfaqësuar kryesisht nga argjila masive me ndërthurje ranorësh.
- Këto të fundit janë vendosur transgresivisht mbi depozitimet e mesinianit (N13m) përfaqësuar nga ndërthurje të pakove ranorike me argjila.

3.1.1 Tektonika dhe sizmiteti ne rajon

Rajoni në tërësi është përfshirë fuqimisht nga lëvizjet shtypëse parapliocenike. Lëvizjet shtypëse që vazhdojnë edhe sot vende-vende deformohen nga shkëputje normale që nga Plioceni. Strukturat neotektonike trashëgohen tërësisht nga strukturat e vjetra duke u riformuar e ngritur më lart në Pliocen – Kuarternar2.

Takohen dhe shkëputje tërthore si ajo Lushnjë-Elbasan. Gjatë etapës neotektonike Ultësira Perëndimore ka pasur prirje në përgjithësi në zhytje, vetëm pas mbarimit të kësaj periudhe, në kuarternar ajo doli mbi ujë.

Ndërsa sot ngritjen e kësaj ultësire e dëshmon zhvendosja e vijës bregdetare nga perëndimi, por në të ka dhe sektorë me prirje në zhytje.

Zona përreth qytetit të Fierit, përfshirë terrenin e propozuar për ndërtimin e impiantit, bën pjesë në zonën e shkëputjeve sizmoaktive Joniko-Adriatike, e cila pozicionohet në pjesën perëndimore bregdetare të Shqipërisë. Në këtë zonë përfshihen disa shkëputje tektonike me drejtim shtrirjeje VP-JL, që zenë vend në një brez të gjerë rreth 40-50 km në jug të tërthores Shkodër-Pejë. Ato janë shkëputje aktive të tipit kryesisht mbihipje. Me këto shkëputje janë të lidhur mjaft tërmete të fuqishëm që kanë goditur vendin tonë dhe vendet fqinjë me ne.

Rajoni i Fierit preket nga shkëputja sizmo-aktive Fier-Durrës me drejtim shtrirjeje VP-JL, e cila kalon nëpër Ultësirën Pranadriatike. Tërmetet në këtë zonë pritet të kenë Mmax midis 6.0 dhe 7.0 (Aliaj 2004). Në bazë të Hartës së sismicitetit të Shqipërisë, kjo zonë bën pjesë në Zonën VIII me shkallë të intensitetit sismik MSK-64.




Figura 4. 6: Harta e Zonimit Sizmik të

3.1.2 Gjeomorfologjia

Lumi i Gjanicës, degë e Semanit, është lumi me ndotje më të rëndë në Shqipëri. Menjëherë pas burimit ai ndotet rëndë me mbeturina me origjinë naftë dhe nënprodukte të saj nga sipërfaqja naftë nxjerrëse e Patos-Marinëz dhe, gjithashtu, prej Uzinës së Përpunimit të Naftës në Ballsh. Duke kaluar mes qytetit të Fierit, përpara se të bashkohet me Semanin në të shkarkohen mbeturinat urbane, duke e bërë ujin e tij pa asnjë formë jete.

Është vlerësuar se çdo muaj në Gjanicë derdhen rreth 12'587-18'091 m³ mbeturina të lëngshme me përmbajtje hidrokarburesh dhe vajra industriale (AKM/NEA, 1997-1998). Në këtë zonë, edhe vlera e BTEX (benzen, toluen, etil-benzen, ksilen) mund të jetë shumë e lartë. Krahas dëmit në florën dhe faunën natyrore ujore, përdorimi i ujit për vaditje dhe blegtori është me rrezik.

Ndikimi ndihet në plazhin e Semanit e me gjere. Ndotja e ujerave sipërfaqësore nga shkarkimet e naftës është prezent në rajonin e monitoruara në nivele të ndryshme. Kjo është në varësi të tipit të ujërave shtresore dhe shkallës së përzierjes së tyre me ujërat sipërfaqësore. Në rajon veçohen këto tip ndotjeje:

- Ndotje nga ujërat e sedimentimit;
- Ndotje nga ujërat e kombinuar (ujërat e sedimentit dhe ujërat shoqërues);
- Ndotje nga ujërat shoqërues të naftës ;
- Ndotje nga ujërat shoqërues me mineralizim të ulet dhe përmbajtje të lartë të naftës;
- Ndotje e ujerave sipërfaqësore nga shkarkimet e ujerave ndotës të naftës. Në ujërat sipërfaqësore përmbajtja e ndotjeve në katerrmujorin e dytë është më e lartë se në katerrmujorin e parë, për shkak të thatësirës së verës;
- Industria nxjerrëse dhe përpunuese e naftës kanë një teknologji të vjetër dhe pajisje mjaft të amortizuara;
- Disiplina teknike në procesin teknologjik të dekantimeve të naftës është e ulët;
- Mjedisi në impiantin e dekantimit Visoke konsiderohet më i ndotur në krahasim me objektet e tjera të QPN Patos. Nga ky impiant shkarkohet 5700-5800m³ ujë/muaj i cili është një potencial i madh ndotjeje për ujërat sipërfaqësore të lumit Gjanice;
- Ujërat shtresore të vendburimit Ballsh, Drenove, Mollas shkarkohen në impiantin e dekantimit Usoje në sasinë 5800-6121 m³/muaj dhe në impiantin e Kashit 2895-3478 m³/muaj, të cilat gjithashtu bëhen një potencial i madh ndotjeje për ujërat e lumit Gjanice dhe rezervuarit të Marushes ku derdhen;
- Krahas shkarkimeve të impianteve të dekantimit Usoje, Kasnice, në lumin Gjanice shkarkohen edhe ujërat teknologjike të uzinave të përpunimit të naftës Ballsh e Fier, duke rritur nivelin e ndotjeve;
- Në lumin Gjanice derdhen edhe llumrat që dalin gjatë pastrimit të depove të lëndës së parë në sasinë 50 ton në vit.




Figura 4. 7: Stacionet e monitorimit të ujërave të ëmbël në Shqipëri

3.1.3 Kushtet klimatike

Shkalla e ndikimit të produkteve të naftës në elementë të ndryshëm të mjedisit është në funksion, ndër të tjera, edhe i nivelit të zhvillimit të faktorëve klimaterikë në zonën në shqyrtim. Kështu, erërat ndikojnë në drejtimin dhe shkallën e përhapjes së gazrave të lëshuara nga përpunimi i naftës. Temperatura dhe diellzimi ndikojnë në shkallën e avullimit të përbërësve të naftës të derdhur në sipërfaqe të tokës.

Lagështia dhe reshjet ndikojnë në shkallën dhe drejtimin e përhapjes së ndotjes së ujërave sipërfaqësorë e nëntokësorë. Për këtë arsye, në vijim bëhet një pasqyrim i kushteve klimaterike të rrethit të Fierit dhe Mallakastrës, nën ndikimin e të cilave është dhe zona e Visokës.

Rrethi i Fierit dhe Mallakastrës janë pjesë e zonës klimaterike mesdhetare. Faktorët që ndikojnë në klimën e zonës janë afërsia me detin Adriatik, topografia me male dhe kodra të ulëta në lindje dhe rrafshinat e ulëta bregdetare. Këto faktorë kanë një ndikim zbutës në klimën e zonës në studim, e cila karakterizohet nga dimra të butë dhe të lagësht si dhe nga vera të nxehta dhe me thatësi.

Temperaturat

Temperaturat mesatare mujore të ajrit variojnë midis 7.2°C në Janar dhe 24.8°C në Gusht. Temperatura mesatare vjetore afatgjatë është 15.9°C. Temperaturat më të larta të regjistruara kanë qenë në Gusht 1957 me afërsisht 45°C dhe temperaturat me të ulëta të regjistruara janë matur në Janar 1968 me pak më shumë së 4.5 °C.

Drita e diellit

Në përgjithësi, kjo zonë karakterizohet nga një numër i lartë orësh me rrezatim diellor në vit me një mesatare prej 2535.8 orë në vit. Sasia mesatare vjetore e energjisë diellore është 4036.0 Wat orë për metër katror dhe ditë.

Reshjet

Zona e Fierit regjistron reshje vjetore mesatare midis 980-1100 mm.


Lagështia

Fieri dhe zona përreth tij karakterizohet nga një nivel relativisht të lartë i lagështisë, me një mesatare vjetore prej 73%. Mesatarja me e ulet e lagështisë së ajrit zakonisht është në Korrik me 67% dhe me e larta në Dhjetor me 78%.

Era

në

era
ere



Drejtimi mbizotërues i erës zonë është nga lindja në juglindje. Era nga deti, d.m.th. nga një drejtim perëndimor ndodh mesatarisht 45 ditë në vit. Karakteristike e zonës është lokale, murrhani, e cila është e nxehte dhe e thate që shkakton probleme shëndetësore.

Përsa i përket shpejtësisë mesatare të erës, për drejtimet korresponduese, ato renditen si me poshtë, vijon: drejtimi S që ka shpejtësi mesatare me te larte prej V=6.7 m/s, pastaj vijnë me radhe, drejtimi SW me 5.8

m/s, drejtimi W me 4.9 m/s, drejtimi SE me 4.5 m/s dhe drejtimi NE me 2.4 m/s. Rastisjet (ne %) te erës sipas drejtimeve kryesore dhe shpejtësitë mesatare koresponduese te tyre janë paraqitur ne figurën 4. 9.

Shpejtësitë me te mëdha mesatare stinore te erës janë: dimri me shpejtësi mesatare 4.9 m/s, pranvera me shpejtësi 4.4 m/s, vjeshta me shpejtësi 4.3 m/s dhe vera me shpejtësi 3.9 m/s. Shpejtësia mesatare vjetore është 4.4 m/s. Në tabelën 4. 6 jepen shpejtësitë e erës sipas stinëve: Ne bregdet, ne përgjithësi, vrojtohen erëra intensive, shpejtësia maksimale e te cilave arrin deri ne 40-45 m/s, veçanërisht për drejtimet N dhe SE. Duhet thënë se, kohëzgjatja dhe rastisja e shpejtësive kaq te mëdha te erës ne hapësirën bregdetare është e rralle dhe me veprim spontan dhe afatshkurtër (tabela 4. 7), kështu qe edhe ndikimi i tyre ne regjimin e valëzimit është i vogël.

Tabela 4.6: Shpejtësitë mesatare stinore të erës (m/s)

Nr.	Stinë	Shpejtësia (m/s)
1	Dimri (XII-II)	4.9
2	Pranvera (III-V)	4.4
3	Vera (VI-VIII)	3.9
4	Vjeshta (IX-XII)	4.3
5	Vjetore (I-XII)	4.4

Tabela 4.7: Frekuenca e tejkalimit të shpejtësisë së erës ndaj drejtimit

Frekuenca e tejkalimit				
Drejtimi (°N)	>2.57 m/s	>7.2 m/s	>15 m/s	>25 m/s
0	5,07	1,8	0,2	0
30	2,64	0,84	0,15	0
60	4	1,25	0,26	0
90	1,77	0,4	0,04	0
120	2,25	0,76	0,06	0
150	12,19	3,99	0,69	0,01
180	4,99	1,61	0,24	0,01
210	1,33	0,41	0,03	0
240	1,98	0,43	0,04	0
270	1,69	0,34	0,04	0
300	2,89	0,83	0,07	0
330	13,34	3,17	0,25	0,01
Omni	54,14	15,83	2,07	0,03

Tabela 4.8: Frekuencat e tejkalimit të vlerave përfaqësuese të shpejtësisë së erës

Shpejtësia e erës (m/s)	Tejkalimi (orë/vit)	Shënime

15	180	Drejtimit 180-150 °V dhe 0-60 °V. Limit për ankorim
20	25	Limiti për shkarkimin e ngarkesës
25	3	Drejtimit 330 °V dhe 180-150 V. Limit për shkëputjen e linjave

Tabela 4.9: Shpejtësitë e skajshme të erës

TR (vjet)	Shpejtësia e erës (m/s)
1	30,0
10	36,8
50	42,0
100	44,0

Ndikim te madh mbi procesin e valëzimit ushtrojnë erërat me shpejtësi qe variojne nga 10 deri 20 m/s (tabela 4. 8), të cilat kane jo vetëm rastisje me te madhe, por edhe drejtim pak a shume te qëndrueshëm. Ne këto kushte, shpejtësia $V=20$ m/s e erës është përzgjedhur si shpejtësia përkatëse për vlerësimin e valëve maksimale llogaritëse për qëllime projektimi.




Figura 4. 10:

Nr.	STINET	Shpejtësia (m/s)
1	Dimri (XII-II)	4.9
2	Pranvera (III-V)	4.4
3	Vera (VI-VIII)	3.9
4	Vjeshta (IX-XII)	4.3
5	Vjetore (I-XII)	4.4

Shpërndarja brenda vjetore e niveleve të ujit (kuota “0” mAbs.)

Tabela 4. 10: Shpejtësitë mesatare stinore të erës (m/s)

3.1.4 Mjedisi tokësor

Toka në të cilën është zhvilluar aktiviteti Uzina e Perpunimit të Naftës vite më parë dhe që do riaktivizohet perseri nuk është tokë natyrale, por e shfrytëzuar për zhvillime industriale. Në këto zone janë përqendruar të gjitha industritë e rënda. Zona e cila ka një sipërfaqe rreth 60ha, zona përfshin Parkun Industrial të Prodhimit të Azotit, zonën e Rafinerisë së Naftës, si dhe ish-TEC-in. Nga këto objekte industriale, aktualisht në funksionim është Rafineria e Naftës, si dhe disa objekte të Azotikut, si objektet që prodhojnë gaz të lëngshëm, kullat e ftohjes etj. Parku i Azotikut përbëhet nga tre seksione, të specializuara sipas prodhimit të dikurshëm: azotiku, ureja e re dhe ureja e vjetër. Aktualisht pjesa më e madhe e objekteve janë privatizuar, dhe janë në proces likuidimi dhe demolimi, për t’u shitur në ankand si pjesë të veçanta

Tipi i tokave pranë zonës së projektit janë ato Livadhore Aluvionale. Tokat aluvionale janë të thella dhe të freskëta. Duke kaluar në thellësi të fushës aluvionale, ato bëhen më të lagura. Në sipërfaqe janë mjaft të shkrifëta, por, për shkak të shtresëzimit të aluvioneve, mbajnë ujë dhe agregatat mund të prishen. Ato kanë nivel të lartë të ujërave nëntokësore, për këtë shkak profili i tyre është plotësisht ose pjesërisht i lagur.

Kur gjendet në tarraca lumore, të vendosura mbi zall e zhavorr, janë të drenuara shumë më mirë se ato të fushës aluvionale. Tokat e tarracave paraqiten të uniformizuara dhe nuk kanë cilësi fluvike. Janë toka me reaksion neutral deri në bazik (pH 7-8) dhe pjellore.

3.1.5 Rrjeti hidrografik natyror i zonës

Sipas SHGJSH-së⁵⁸ Bashkia Fier ka pasuri të shumta ujore pasi në territorin e saj kemi dy lumenj kryesorë të Shqipërisë dhe Fieri ndahet në basenat e Semanit dhe Vjosës. Përveçse këtyre lumenjve të rëndësishëm kemi edhe lumin Gjanica i cili kalon përgjatë qytetit të Fierit. - Lumi Seman Përshkon me dredhime për 61 km Fierin dhe fushën e Myzeqesë. Në veri të qytetit të Fierit pranë fshatit Mbrostar ai merr me vete edhe Gjanicën dhe derdhet në det duke formuar një deltë të madhe. Gjanica është një nga afluentët e Semanit. Pasi përshkon 42 km përgjatë Mallakastrës, ajo futet në qytetin e Fierit dhe më pas bashkohet me Semanin. Lartësia mesatare e pellgut ujëmbledhës të lumit Seman prej 863 m mbi nivelin e detit tregon se ky lum grumbullon ujërat e një territori të theksuar malor. Vlerat e larta dhe pothuajse të përafërta të lartësive mesatare të pellgjeve ujëmbledhëse të lumenjve Osum (825 m) dhe Devoll (950 m), tregojnë se jo vetëm Semani në përgjithësi, por edhe dy afluentët e tij në veçanti, karakterizohen nga e njëjta natyrë malore e

konfiguracionit të pellgut ujëmbledhës. Në përgjithësi sipërfaqja e pellgjeve ujëmbledhëse të lumenjve afluentë Osum e Devoll, përfshihet në zonën malore dhe kodrinore të pellgut ujëmbledhës (Seman), ndërsa pjesa fushore fillon rreth zonës së bashkimit të këtyre dy lumenjve afluentë e deri në derdhjen e Semanit në detin Adriatik. Lumi Seman dhe dy afluentët e tij kryesor: lumenjtë Osum dhe Devoll, përshkojnë të gjitha zonat tektonike të Shqipërisë, të cilat karakterizohen nga një strukturë e ndërlikuar me toka të përshkueshme prej 21 % të sipërfaqes së përgjithshme të pellgut ujëmbledhës, gjysëm të përshkueshme prej 51 % dhe të përshkueshme prej 28 %.

Pellgu më i afërt pranë zonës së projektit është ai i lumit Gjanica. Lumi i **Gjanicës**, degë e Semanit, është lumi me ndotje më të rëndë në Shqipëri.

Menjëherë pas burimit ai ndotet rëndë me mbeturina me origjinë naftë dhe nënprodukte të saj nga sipërfaqja naftë nxjerrëse e Patos-Marinzës dhe, gjithashtu, prej Uzinës së Përpunimit të Naftës në Ballsh. Duke kaluar mes qytetit të Fierit, përpara se të bashkohet me Semanin në të shkarkohen mbeturinat urbane, duke e bërë ujin e tij pa asnjë formë jete. Është vlerësuar se çdo muaj në Gjanicë derdhen rreth 12'587-18'091 m³ mbeturina të lëngshme me përmbajtje hidrokarburesh dhe vajra industrial (AKM/NEA, 1997-1998). Në këtë zonë, edhe vlera e BTEX (benzen, toluen, etil-benzen, ksilen) mund të jetë shumë e lartë. Krahas dëmit në florën dhe faunën natyrore ujore, përdorimi i ujit për vaditje dhe blegtori është me rrezik.

4 Pellgu ujëmbajtës i luginës së lumit Gjanica

Zona ku do të kryhet veprimtaria përgjithësisht nuk përshkohet nga lumenj të mëdhenj e të njohur apo nga përrenj me rrjedhje të qëndrueshme. Relievi disi i thyer nga një sërë kodrash, në mënyrë periodike gjatë kohës së reshjeve të mëdha atmosferike ka kushtëzuar formimin e rrëqeve të parëndësishme që në fund të fundit do përfundojnë në rrjedhën e lumit Gjanica. Ky lumë, aq sa mban mënd kujtesa popullore, nuk ka ngjarë të thahet ndonjë vit, dhe prurjet e tij gjatë dimrit mund të jenë aq të mëdha sa për të shkaktuar përmytje. Nga vrojtimit hidro-metereologjike të kryera vite me radhë rezulton se sasia mesatare e prurjeve të tij është rreth 18.5 m³/sek (tabela 4. 13), ndërsa shpërndarja e tyre gjatë vitit mund të shihet në grafikun e figurës 4.6. ku mund të dallohet muaji me plota që është perioda shkurt mars me 150 m³/sek.

Regjimi i rrjedhjes së lëngët të Gjanicës është i tipit torrencial, sepse ai ushqehet kryesisht nga ujërat sipërfaqësorë (69 %) dhe më pak nga ato nëntokësorë (32%). Gjanica ka gjatësi 67 km buron nga burimet e Pocemit e te Kalivaçit. Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës është 234 km².

3.1.6 Kushtet atmosferike

Cilësia e ajrit-Shkarkimet e gazeve acide në atmosferë kanë një ndikim negativ mbi ekosistemet e ujërave të ëmbla, të cilat janë të ndjeshme ndaj aciditetit si edhe ndaj cilësisë dhe përbërjes kimike të tokës. Gjithashtu, kjo dukuri shkakton dëmtime në trashëgiminë kulturore sepse pakëson gradualisht cilësinë dhe fortësinë e monumenteve kulturore, ndërtesave prej mermeri etj. Për më tepër, çlirimi i përbërësve të azotit në atmosferë, shkakton atrofizimin në ekosistemet tokësore dhe detare.

Burimi kryesor i çlirimeve të substancave acide në mjedis janë emetimet e gazta, që përmbajnë dyoksid sulfuri SO₂, okside të azotit NO_x dhe amoniak NH₃.

Këto gaze krijohen gjatë djegies së substancave organike të djegshme në sektorët e shërbimeve, transportit, prodhimit të energjisë, industrisë kimike dhe metalurgjike etj. Pas çlirimit në atmosferë, këto gaze shpërndahen në hapësirë dhe mund të qëndrojnë për disa kohë në gjendje të shpërhapur. Gazet SO₂, NO_x, dhe NH₃ bien direkt në sipërfaqen e tokës dhe vendosen në bimësi dhe elementë të tjerë mjedisorë ose bien në gjendje të lagësht së bashku me borën, shiun, mjegullën etj. Këto gaze (si rezultat i zhvillimit të disa reaksioneve kimike) shndërrohen në acide squfuri dhe azoti kur ato qëndrojnë në atmosferë, si edhe kur bien në tokë.


Gjatë analizës së thelluar të gjendjes së mjedisit në territor dhe ajrit, u vu re se cilësia e ajrit në Bashkinë Fier nuk është e mirë, kryesisht në zonat më të populluara urbane dhe 377 në zonat naftënxjerrëse. Burimet e ndotësve të cilësisë së ajrit janë kryesisht mjetet e transportit (në zonat urbane), cilësia jo e mirë e naftës së përdorur nga mjetet e transportit, industria e rëndë dhe kryesisht industria e naftës së bashku me sektorë të tjerë të ekonomisë si ndërtimi. Në analizë u vu re edhe mungesa e një monitorimi të vazhdueshëm të cilësisë së ajrit gjatë gjithë vitit (monitorimi në një numër shumë të kufizuar ditësh gjatë vitit dhe mungesa e një rrjeti monitorimi me pajisje fikse në pika të caktuara në Bashki për monitorimin e përhershëm ose ditor të cilësisë së ajrit). Me qëllim përmirësimit të cilësisë së ajrit dhe përmirësimit të cilësisë së jetës së banorëve të saj, Bashkia Fier ka parashikuar marrjen e disa masave në Planin e Përgjithshëm Vendor të cilat parashikojnë uljen e mdatjes nga mjetet e transportit. Këto projekte parashikojnë uljen e numrit të makinave në qarkullim nëpërmjet fuqizimit të transportit publik dhe nxitjes së transportit alternativë (siç është transporti me biçikleta), dhe uljen e qarkullimit të numrit të makinave në zonat urbane, shtimin e sipërfaqeve të gjelbra në qytet, hartimin e planeve për uljen e shkarkimeve në ajër nga industria e rëndë, si dhe planifikimin eficient të territorit.

Me poshte gjeni te dhena per matjet e realizuara te cilesise se ajrit:

Grimcat PM 2.5


PM 2.5 jane gramcat e pluhurit me diameter te barabarte dhe me te vogel se 2.5 mikron, ndryshe quhen dhe grimcat ultrafine. Keto grimca jane te rrezikshme per shendetin e popullotes, pasi depetojne thelle ne mushkri duke shkaktuar probleme serioze te cilat te cojne dhe ne vdekje te parakoheshme.

Vlerat mesatare vjetore te PM 2.5



3.1.7 Zhurmat


Vlera mesatare e nivelit te zhurmave ne 4 pikat e monitorimit te qytetit te Fierit Diten dhe Naten



Nga tabela e mesiperme vërejmë se në të gjitha pikat e monitorimit të qytetit të Fierit kemi nivel zhurme për Diten më të lartë se standarti i BE-se. Përsa i takon nivelit të zhurmës për Naten vërejmë se pika e monitorimit “Kryq. i Hyrjes me Unazën” është nën vlerën e standarteve të BE-se, ndërsa pikat e tjera janë mbi nivelin kufi.


Paraqitja tabelore e vlerave mesatare të dites. Laeq/Diten, për të gjitha pikat e monitorimit të qytetit të Fierit në 5 vitet e fundit të monitorimit

Pikat e monitorimit	2007	2008	2010	2011	2014
Kryq. i hyrjes me Unazën	68	60.3	63.8	60.1	59
Përballë prefekturës	67	66.6	61.2	64.1	63.7
Kryqëzimi për Vlorë	67		65.2	62.8	56.9
Përballë Bankës(Tregu)	69	64.7	60.8	64.6	63.8
Standarti i BE					55



Paraqitja tabelore e vlerave mesatare të nates. Laeq/Naten, për të gjitha pikat e monitorimit të qytetit të Fierit në 5 vitet e fundit të monitorimit

Pikat e monitorimit	2007	2008	2010	2011	2014
Kryq. i hyrjes me Unazën	46	42.4	44.4	42.7	44.9
Përballë prefekturës	43	41.2	49.6	47.4	54.2
Kryqëzimi për Vlorë	48		44.4	53.3	46.9
Përballë Bankës(Tregu)	46	46.4	45.2	49.7	47.8
Standarti i BE					45



3.1.7 Zonat e Mbrojtura

Zonat e mbrojtura përfaqësojnë territore tokësore, ujore, detare e bregdetare të caktuara për mbrojtjen e diversitetit biologjik, të pasurive natyrore dhe kulturore, bashkëshoqëruese, të cilat menaxhohen me rrugë ligjore dhe me metoda shkencore bashkëkohore. Ato shpallen me Vendim të Këshillit të Ministrave dhe, në zbatim të Ligjit nr.8906 datë 06.06.2002 “Për zonat e mbrojtura”, sipas kategorive përkatëse zbatohen shkallë të ndryshme mbrojtjeje.

Zona e propozuar për zhvillimin e aktivitetit nuk ndërpret asnjë prej zonave të mbrojtura të vendit tonë. Zona e vetme e mbrojtur në afërsi të zonës së Mbrojtur “LEVAN”, ME Vendim me të cilin është shpallur: MB Rreg. Nr. 1, date 27.07.1977. Ajo zë një sipërfaqe prej 200 ha dhe në të zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes. ajo NDODHET E DISTANCUAR ne nje distance prej 2.3 km ne jug-perendim te siperfaqes se aktivitetit ne fjale. Njëkohësisht ajo nuk ka pikëprerje as me ndonjë nga monumentet e natyrës të rrethit Fier, shpallur të tilla me VKMnr. 676 datë 20.12.2002 “Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare”.



3.1.8 Mjedisi biologjik i rajonit

Flora dhe fauna

Karakteristika te përgjithshme te mjedisit natyror

Rrethi i Fierit ofron dhe potenciale te rëndësishme natyrore për zhvillimin e tij. Ne përgjithësi kemi te bëjmë me një rajon fushor me lartësi nga 0-100 m mbi nivelin e detit dhe me toka shumë pjellore. Edhe relievet kodrinore janë përgjithësisht te buta dhe te mundshme për shfrytëzim bujqësor. Ne zonat e rrafshëta zhvillohen tokat e hirta kafe. Kemi edhe lloje te veçanta tokash si aluvionale qe takohen ne luginat e Semanit e Vjosës, tokat e kripura qe shtrihen ne Hoxhare si dhe tokat moçalishte te Roskovecit. Ne rrethin e Fierit shtrihet një pjesë e Myzeqesë se Madhe, Myzeqeja e Vogël dhe fushat e Frakullës e te Cakranit. Klima e Fierit është e ngrohte sepse Fieri laget nga deti dhe është i mbrojtur nga lindja prej erërave te ftohta. Fieri dallohet për numrin e lartë te ditëve me diell mesatarisht 2800 ore ne vit. Erërat fryjnë ne drejtime të ndryshme por gjatë dimrit mbizotëron era e jugut, e cila sjell edhe reshje te mëdha, ndërsa gjatë verës era fryn nga veriu dhe veriperëndimi. Afërsia me detin bën qe klima te jetë e bute dhe vetëm ne raste tepër te rralla temperaturat te bien nën zero.

⇒ **Ekonomia**

Rrethi i Fierit është ekonomikisht një nga rrethet me te zhvilluara te Shqipërisë. Ne këtë zhvillim veçojmë tre periudha te rëndësishme kohore : paraçlirimit, vitet 45-90-te dhe pas viti 1990. Periudha e tretë pas viteve 90-te është shoqëruar me ndryshime te mëdha edhe ne strukturën e ekonomisë. Kjo si rezultat i ndryshimit te formës se pronësisë, nga ajo shtetërorë ne atë private. Sot ne rrethin e Fierit ne industrinë e nxjerrjes dhe përpunimit te naftës, veprojnë dy nga kompanitë me te mëdha ne Shqipëri, Albpetrol dhe ARMO si dhe kompania kanadeze “Banker’s “. Ndërsa përta i përket marrëdhënieve agrare, edhe ato njohën ndryshime rrënjësore. U kalua nga sistemi i kooperativave dhe NB-ve ne sistemin e pronës private dhe te ekonomisë te tregut te lirë. Ne rrethin e Fierit procesi i ndarjes se tokave ka përfunduar ne vitin 1993 dhe toka është shpërndarë sipas kriterëve te përcaktuara ne Ligjin për Token. Shpërndarje e tokës është bërë ne varësi te sipërfaqes se përgjithshme te tokës se punueshme me numrin e banoreve. Kështu çdo person ka përfituar nga 0.15-0.3 ha. Këto kanë sjelle rritjen e shpejte te numrit te njërive te prodhimit bujqësor. Bujqësia private dominohet nga fermat qe operojnë ne nivel familjar.

⇒ **Turizmi dhe pasuritë Social – Kulturore**

Vlerësimi turistik i këtyre motiveve nënkupton kulturën shpirtërore, materiale e origjinale. Elemente te tillë si : veshja, këngët dhe valle, instrumentet muzikore, doket dhe zakonet, fjalët e urta dhe legjendat, feja me institucionet e saj, muzeumet prezantojnë shpesh vlera te rralla e te papërsëritshme.

⇒ **Jeta shpirtërore**

Rajoni Vjose – Seman ka veçoritë e veta përta i përket jetës shpirtërore. Ky rajon bën pjesë ne krahinën etnografike te Myzeqesë. Turizmi fetar është lloji me i vjetër i turizmit, praktikuar qe ne kohët e lashta. Ne rajon ekzistojnë dy bashkësi fetare, ajo ortodokse dhe ajo myslimane. Të dy bashkësitë fetare jetojnë ne harmoni te plotë me njëra – tjetrën. Me shumë interes janë objektet e kultit qe paraqesin interes nga ana arkitektonike dhe nga ana e misionëve fetare. Me vlera te shumanshme do të veçonim kishën e Shën Marise se Pojanit dhe afresket e shekullit XIV qe ruhen aty. Me interes janë pagëzimet dhe kurorëzimet qe bëhen ne kisha, si dhe ritet fetare qe i shoqërojnë. Ne afërsi te Kolkondasit ne vitin 1813 është ndërtuar Manastiri i Shën Kozmait, ku ne 24 usht te çdo viti organizohet Panairi i Shën Kozmait, ku besimtare nga e gjithë Myzeqeja shkojnë ne ceremoni. Objekte te tjera janë kisha ortodokse e Shën Gjergjit, kisha katolike, xhamia etj.

4 PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

4.1 Qellimi i aktivitetit

Qellimi i funksionimit te ketij aktiviteti eshte “Uzina e Perpunimit te Naftes” me vendodhje ne Kompleksin Industrial te qytetit Fier.

Subjekti investitor:


Shoqeria “AL.GLOBAL OIL” Sh.p.k me NIPT L62214509P, me seli ne Tirane, Njesia Administrative Nr.5,Rruga "Sulejman Delvina", Ndertesa.11, Hyrja 10, Ap.7,1019. dhe ka si administrator Z. Shaban Guni. Aktiviteti i ketij subjekti sipas ekstraktit te QKR-se fusha e veprimtarise specifikohet:


Importin dhe eksportin e hidrokarbureve te gjitha llojeve, te karburanteve, naftes, gaz dhe nenprodukteve te tyre me shumice si dhe perpunimi i naftes bruto dhe nenprodukteve te saj.

4.2 Vendodhja e aktivitetit

Ky aktivitet ndodhet ne Jug-Perendim te Ish Azotikut, ne kompleksin Industrial te qytetit te Fierit, Bashkia Fier. Siperfaqja e sheshit ne dispozicion eshte 70 000 m².

Sheshi ne dispozicion te impjantit identifikohet sipas ortofotove te meposhtme:





4.3 Te dhena teknike te aktivitetit

4.3.1 Procesi Teknologjik i Prodhimit te Rafinerise Fier

Uzina e Perpunimit te Naftes Fier eshte ndertuar ne vitet '60 dhe ka filluar aktivitetin e saj perpunues ne vitin 1968. Eshte projekt sovjetik dhe e vene ne pune nga specialist shqiptar. Teknologjia eshte e vjeter dhe funksionon me nje proces primar dhe jo te thelluar si K.P.TH.N.Ballsh. Produkti perfundimtar, i cili eshte i destinuar per tregetim, me standart perkates, eshte bitumi.

Kapaciteti i projektuar perpunues i Impiantit te Distilimit eshte 500 000 ton/vit nafte bruto.

Rafineria e Fierit eshte e perbere nga impiantet e meposhtme:

1. Reparti A.V.T Distilimit Atmosferik dhe ne Vakum
2. Reparti Mekanik
3. Reparti i Kip Elektrikut
4. Reparti i bitumit
5. Parku i rezervuareve te lendes se pare
6. Parku i rezervuareve te gjysemprodukteve dhe holluesit
7. Parku i rezervuareve te bitumit

1. Reparti A.V.T Distilimit Atmosferik dhe ne Vakum ka per qellim perpunimin e lendes se pare , naftes brut, dhe nxjerrjen e nenprodukteve te saj si benzine, hollues, solar, mazut dhe bitum .
2. Reparti Mekanik - Ne perberjen e U.P.N.Fier funksionon dhe Reparti Mekanik, i cili prodhon pjese kembimi per perballimin e nevojave dhe problemeve qe mund te dalin gjate proceseve teknologjike. Ne perberje te ketij reparti jane paisjet si torno, pjese, etj.te chat sigurojne prodhimin e pjeseve te kembimit per mirmbajtjen e aparaturave dhe paisjeve ne uzine, si dhe per kryerjen e remonteve te radhes ne rafineri.
3. Reparti i Kip-Elektrikut - Ushtron aktivitetin per mbajtjen ne gatishmeri te plate te aparateve mates dhe te kontrollit te procesit teknologjik, si dhe te paisjeve elektrike. Kryen ne menyre periodike sherbime, riparime dhe remonte te aparateve te kipit, si dhe ato elektrike. Gjithashtu kryen dhe riparimin e kabines elektrike te tensionit te larte.

4.3.2 Teknologjia

Impjantet e rafinerise jane teknologji Sovjetike te cilat here pas here i jane nenshtuar remonteve per ti mbajtur ato ne pune .

4.3.3 Pershkrimi i Skemes Teknologjike te Uzines se Perpunimit te Naftes Fier

Pershkrimi i linjes se Naftes Bruto

Nafta bruto nga rezervuaret e manipulimit R1,R2 dhe R3, me temperature 30-70°C dhe me densitet 0.960-1.00kg/m³, me permbajtje uji deri ne 3%, nepermjet pompave me avull, me piston 2QYR-40, te linjave A dhe B dhe me presion jo me te larte se 25 atm, dergohet perkatesisht ne seksionet A dhe B te furres FI AB. Nafta tashme me temperature 50-70°C nepermjet linjave Adhe B futet ne tubot e konveksionit te poshtem e pastaj ne ato te konveksionit te siperm te furres ku ngrohohet deri ne temperaturen 130°C. Prej konveksionit te siperm te furres nafta shkon ne bllokun e dehidratoreve, ku ne temperaturen 130°C dhe presion 13 atm realizohet ndarja e ujit nga nafta. Nafta brut e dehidratuar dergohet ne zonen e poshtme te radiacionit te furres F1, nga ku del me temperaturen 120°C dhe pastaj kalon perkatesisht ne radiacionet e siperme prej nga del me 350°C

Nafta bruto del nga furra dhe pasi kalon ne nje kolektor ku i bie presioni deri ne 2,5 atm dergohet ne Kollonen e Distilimit Atmosferik.

Pershkrimi i Procesit Teknologjik te Prodhimit te Holluesit

Nga pjesa e siperme e kollones Atmosferike te Distilimit, del holluesi me temperature jo me te larte se 115°C, i cili kondensohet ne kondensatorin perkates dhe del prej andej me temperature 40°C. Nga kondensatori holluesi kalon ne seperatorin e ujit, ku nga pjesa e poshtme e tij shkarkohet vazhdimisht uji qe eshte ne perberje te holluesit ndersa ne pjesen e siperme merret holluesi. Nga seperatori, holluesi, me ane te pompes centrifugale dergohet ne rezervuarin R5 te holluesit , ne Parkun e e Gjysem Produkteve.

Pershkrimi i Procesit Teknologjik te Prodhimit te Mazutit

Mazuti del nga fundi i kollones se Distilimit Atmosferik, me temperature 350°C dhe futet ne pompen e mazutit, ku i rritet presioni jo me teper se 10 atm dhe pastaj dergohet per ngrohje ne furren F3, ku ngrohohet deri ne 400°C dhe sipas rastit dergohet ose ne kollonen e vakumit, per te prodhuar bitum, ose dergohet ne ftohsin e mazutit, ku ftohet me uje deri ne 220°C. Nga ftohesi mazuti dergohet sipas nevojave te tregut ne rezervuaret R1,R2,R3,R4,R5 te Objektivit 5 qe eshte Reparti i Shitjes se Bitumit te lengshem dhe solarit.

Pershkrimi i Procesit Teknologjik te Prodhimit te Lendes djegese- Solar.

Lenda djegese (solar) del nga kollona e distilimit atmosferik, nepermjet dy linjave dhe dergohet ne kollonat e strepingut KS1 dhe KS2, ku nxehet me avull per largimin e fraksioneve te lehta qe mund te kene ngelur ne te. Lenda djegese (solar), del nga kollonat e strepingut ku bashkohen ne nje linje te vetme dhe shkojne ne ftohsat me uje te lendes djegese, ku i ulet temperatura deri ne 55°C. Prej ketej lenda djegese, e ftohur, shkon ne rezervuaret P1,P2,P3,P4,P5,P6 sipas rastit. Nga keta rezervuar lenda djegese me ane te pompes centrifugale me presion 5 atm dergohet ne keto destinacione:

- Ne furrat F1 dhe F3 per djegje
- Ne ftohsat e bitumit dhe mazutit per larjen e tyre kur dalin ne remont
- Ne rezervuarin RI 50 m³ te Repartit te Kaldajave per konsum vetjak, si dhe
- Ne rezervuarin R6 te Repartit te Magazinimit, Shitjes se Bitumit te lengshem dhe lendes djegese(solar) per larjen e pompave, linjave dhe paisjeve te bitumit, pasi perfundon shitja e bitumit te lengshem
- Ne rezervuaret R3,R4,R5 te Repartit te Magazinimit, Shitjes se Bitumit te lengshem dhe lendes djegese

Pershkrimi i Teknologjiise se Prodhimit te Bitumit

Bitumi eshte produkt i fundit te kollones se Vakumit, i cili pasi futet ne pompen e bitumit ku i rritet presioni jo me shume se 10 atm, ftohet ne ftohesin e bitumit me uje deri ne temperaturen 200-225°C dhe prej ketej dergohet ne repartin e Magazinimit, Shitjes se bitumit te lengshem. Hyrja e bitumit neper rezervuar behet nga siper nepermjet nje kolektori, qe i pershkon me radhe te gjitha rezervuaret.

Bitumi i grumbulluar ne rezervuare, pasi rezulton me karakteristika te rregullta, te percaktuara keto ne Laboratorin Kimik te Uzines se Perpunimit te Naftes ne Fier, shkarkohet ne fuci, autobote, apo cisterna, me ane te dy pompave perkatese.

Bitumi nga kazanet me ane te kolektorit te brendshem me diameter 200 mm, i cili eshte i vendosur ne krah te sallave te bitumit, dergohet ne vaske, ku prej ketu, me anen e pompave te sallave dergohet, me pare, ne kolektorin e shperndarjes se bitumit dhe prej ketuj me anen e tubacioneve, me diameter 100 mm, dergohet ne sallat e bitumit, ku nje pjese shkarkohet ne fuci dhe pjesa tjeter detyrimisht duhet te kthehet ne vaske nepermjet linjes se kthimit.

Kthimi i bitumit eshte i detyrueshem, per shkak te mbajtjes se linjave te shkarkimit te bitumit te ngrohta dhe te menjanimit te ngrirjes.

Ne rastet e zvogelimit te rrjedhjeve te kthimit te bitumit ne vaske, menjehere duhet te ndalohet shkarkimi i bitumit ne fuci, cisterna, ose autobote dhe presohen linjat deri ne rrjedhjen e plote te bitumit, nga seksioni i tubacionit.

Nepermjet kolektorit te jashtem me diameter 150 mm bitumi shkarkohet me pare ne vaske dhe prej ketuj me anen e pompave 2QYR30 112/25 te salles Nr.2 dergohet ne kolektorin e shperndarjes se bitumit, qe e dergon ate ne salle, per mbushjen e fucive, per ngarkim ne linjen me diameter 100 mm te ngarkimit te cisternave dhe autoboteve, si dhe ne rezervuar.

Gazet qe clirohen nga rezervuaret, e mbushur me bitum, nepermjet kolektorit me diameter 350 mm futen ne pjesen e poshtme te kondensatorit (skruberit) te perzjerjes nga pjese e siperme e te cilit injektohet uje ne formen e dushit qe, duke rrene ne kontakt me avujt dhe gazet, qe ngjiten lart, nje pjese e tyre kondensohen dhe se bashku kalojne ne pusetat teknologjike, per ne bllokun e pastrimit, ndersa pjese tjeter, qe mbetet pa u kondensuar, shkarkohet ne atmosfere nepermjet oxhakut.

Kapacitetet stokuese te lendes se pare dhe te nenprodukteve te saj

- | | | |
|-----------------------------|----------------------------------|-----------------|
| ○ Parku i Naftes Brut | - Rezervuare 2000 m ³ | cope 3(tre) |
| ○ Parku i Gjysem/produkteve | - Rezervuare 400 m ³ | cope 4(kater) |
| ○ Parku i Shitjeve | - Rezervuare 200 m ³ | cope 5(pese) |
| ○ Parku i lendes djegese | - Rezervuare 100 m ³ | cope 6(gjashte) |

Skema e furnizimit te impiantit me lende te pare bashke me metodiken e maties

Nafta brut nga rezervuaret e manipulimit R1,R2 dhe R3, me temperature 30-70°C dhe me densitet 0.960-1.00kg/m³, me permbajtje uji deri ne 3%, nepermjet pompave me avull, me piston 2QYR-40, te linjave A dhe B dhe me presion jo me te larte se 25 atm, dergohet perkatesisht ne seksionet A dhe B te furrës FI AB. Nafta tashme me temperature 50-70°C nepermjet linjave A dhe B futet ne tubot e konveksionit te poshtem e pastaj ne ato te konveksionit te siperm te furrës FI , ku ngrohet deri ne temperaturen 130°C. Prej konveksionit te siperm te furrës nafta shkon ne bllokun e dehidratoreve, ku ne temperaturen 130°C dhe presion 13atm realizohet ndarja e ujit nga nafta. Nafta brut e dehidratuar dergohet ne zonen e poshtme te radiacionit te furrës FI, nga ku del me temperaturen 120°C dhe pastaj kalon perkatesisht ne radiacionet e siperme prej nga del me 350°C

Nafta brut del nga furra dhe pasi kalon ne nje kolektor ku i bie presioni deri ne 2.5 atm dergohet ne Kollonen e Distilimit Atmosferik.

Matja e sasise se lendes se pare dhe nenprodukteve te saj realizohet me meter shirit duke ju referuar kalibrofkatve te cdo rezervuari. Furnizimi i impiantit me lende te pare realizohet me veterrrjedhje, pasi edhe rezervuaret e lendes se pare jane te instaluar me larte se impianti.

Perdorimi i Lendes djegese

Lenda djegese qe perdoret ne rafineri ne menyre indirekte si autokonsum. Agjenti ngrohes i perdorur ne teknologji eshte lenda djegese qe perdoret ne repartin e ATV si dhe avulli i perftuar nga kaldajat te cilat perdorin si material djeges solarin.

Solari (lenda djegese) qe prodhohet ne repartin e distilimit atmosferik sherben:

- per djegie ne furrat e distilimit atmosferik FAB dhe ne Furren e vakumit F3
- per djegie ne sprucatorin e kaldajave
- per larje te linjave teknologjike qe kane patur bitum ose mazut

